

## TEKSTI I RI “PEDIATRIA”- NJE RISI

Para pak muajsh, doli nga botimi teksti “PEDIATRIA”- tekst per studentet e Fakultetit te Mjekësisë.

Në hartimin e tij kanë marrë pjesë të gjithë pedagogët e Departamentit të Pediatrisë, ku secili ka përshkruar patologjitë kryesore të nënspecialitetit të tij, nën drejtimin e Prof. Dr. Eli Foto.

Botimi i parë i tekstit të Pediatrisë në gjuhën shqipe është shkruar nga **Prof. Selaudin Bekteshi**, në vitin 1974.

Më pas u botua, në vitin 1998, libri i Pediatrisë, nga **Prof. Durim Bebeci**, libër i destinuar për mjekët pediatër, mjekët e përgjithshëm, mjekët e familjes dhe ata të shërbimit parësor, i cili ka qënë i vlefshëm për praktikën e përditshme mjekësore pediatrike.

Domosdoshmëria për një libër pediatrie ishte ndjerë prej kohësh për t’i afuar studentëve një informacion didaktik, me të dhënat e fundit të përditësuara, si në aspektin teorik dhe atë praktik. Tematika e përzgjedhur është mbështetur në kurrikulat e kësaj lënde si për studentët ashtu dhe për mjekët specializantë – pediatër.


Parimet e trajtimit për secilën patologji, janë përgatitur sipas protokolleve të mjekimit, të aprovuara për vendin tonë nga OBSH dhe Ministria e Shëndetësisë, gjithmonë në përputhje me të dhënat më të fundit të literaturës bashkëkohore të mjekësisë, të mbështetur në evidencë (evidence based medicine).

Pothuajse të gjitha temat në tekst, janë të shoqëruara me një material grafik, skema të thjeshta të ilustruara si dhe foto demonstrative, shpeshherë nga pacientët e diagnostikuar në praktikën tonë të përditshme, duke i dhënë librit kështu, origjinalitetin e eksperiencës shqiptare.

Duke pasur parasysh që popullata pediatrike në Shqipëri zë një të tretën e popullatës së përgjithshme dhe sipas censusit të fundit, numërohen rreth 900 000 fëmijë të moshës 0-14 vjeç, rëndësia praktike e librit e kalon kufirin e mësimdhënies.

Aty gjendet material informativ që mund të përdoret dhe nga mjekët e shërbimit parësor që ballafaqohen me probleme të puerikulturës, si edhe të sëmundshmërisë të kësaj grupmoshe.

***Falenderojme të gjithë bashkëpunëtorët që kontribuan në hartimin e këtij libri dhe urojme që ky tekst të shërbejë për zgjerimin e dijeve në auditoret si dhe për perfeksionimin e cilësisë së shërbimit ndaj atij brezi të popullatës, të cilit i dedikohet e ardhmja e shoqërisë sonë.***



## TEKSTI: "PEDIATRIA"–TEKST PER STUDENTET E STOMATOLOGJISE

Ne duart e studenteve te Fakultetit te Stomatologjise, Universitetit Mjekesor, Tirane, tashme ndodhet teksti i ribotuar "Pediatria".

Eshte nje pune e mjekeve te njohura pediatre: ***Prof. Dr. Eli Foto, Prof. Dr. Luljeta Serbo, Prof. Dr. Anila Godo.***

Autoret jane perpjekur te prekin e te trajtojne probleme te rendesishme te patologjive pediatrike, qe duhet te dije mire nje mjek stomatolog, para, gjate dhe pas manipulimit ne femijet.